



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

**BASHKIA TIRANË**  
**AGJENCIA E MBROJTJES SË KONSUMATORIT**

**FTESE PËR OFERTË**

**Emri dhe adresa e autoritetit kontraktor**

Emri Agjencia e Mbrojtjes së Konsumatorit  
Adresa Rruga “Murat Toptani” 1001, ndertesa 12, Kati 2, Tiranë  
Tel/Fax 0692363325  
E-mail gertila.nikolli@tirana.al  
Adresa e Internetit [www.mbrojtjakonsumatorit.al](http://www.mbrojtjakonsumatorit.al)

Autoriteti Kontraktor, Agjencia e Mbrojtjes së Konsumatorit zhvillojë procedurën e prokurimit për blerjen e biletave të transportit ajror ndërkombëtar me objekt: “**Blerje 1 (një) bileta udhëtimi vajtje-ardhje Tiranë - Dubai - Tiranë**”.

Data e zhvillimit do të jetë 24.11.2023, ora 14:00 në adresën [www.app.gov.al](http://www.app.gov.al)

Jeni të lutur të paraqisni ofertën tuaj për këtë objekt prokurimi me këto të dhëna (specifikimet teknike të mallit/shërbimit/punës):

Nr.	Përshkrimi i Mallit/ Shërbimit/Punës	Njësia Matese	Sasia
1.	Blerje biletë transporti ajror ndërkombëtar Tiranë - Dubai - Tiranë”, në datën 30 Nëntor 2023– 05 Dhjetor 2023	Biletë	1

- Nisja nga Tirana drejt Dubait do të bëhet në datën 30.11.2023 në orën 18:55, mbërritja në Dubai në datën 01.12.2023, në orën 06:55.
- Kthimi nga Dubai drejt Tiranës do të bëhet në datën 05.12.2023 në orën 02:55, mbërritja në Tiranë, në orën 11:50.

(Me një ndalesë, bagazhe të përfshira) .

Në çmim të përfshihet edhe siguracioni i shëndetit në udhëtim.

Operatori ekonomik i renditur i pari, përpara se të shpallet fitues, duhet të dorëzojë dokumentet si më poshtë:

a) ***Rezervimin e biletës sipas destinacionit të kërkuar.***

*\*Operatori ekonomik së bashku me itinerarin e ofruar, duhet të paraqesë edhe të dhënat e kontaktit (numër telefoni, e-mail) në sistem. Nëse itinerari i ofruar nga OE është në përputhje me kërkesat e AK dhe sipas destinacionit të kërkuar, Autoriteti Kontraktor pas konfirmimit do të nis të dhënat e personave udhëtues në adresën elektronike (email) të Operatorit ekonomik.*

Operatori ekonomik duhet të ketë të përfshirë në fushën e veprimtarisë së tij në QKR, objektin e prokurimit.

Me marrjen e njoftimit, ofertuesi i renditur në vend të parë duhet t'i përgjigjet Autoritetit Kontraktor, Agjencia e Mbrojtjes së Konsumatorit për realizimin apo pamundësinë e realizimit të objektit të prokurimit, brenda 2 (dy) orëve nga momenti i njoftimit të operatorit nga Komisioni i sistemit dinamik të biletave. Në rast të pamundësisë së realizimit të objektit të prokurimit duhet të jepen arsyet që kanë shkaktuar pamundësinë e realizimit të objektit.

Operatori ekonomik i shpallur fitues duhet të dorëzojë biletën elektronike elektronikisht (email: gertila.nikolli@tirana.al brenda 2 (dy) orëve nga momenti i shpalljes së fituesit.

Në rast se ofertuesi i shpallur fitues tërhiqet nga oferta e tij, nuk paraqitet në afatin kohor, ose nuk plotëson kërkesat e përcaktuara nga Autoritetit Kontraktor Agjencia e Mbrojtjes së Konsumatorit në "Ftesën për ofertë" do të përzgjidhet ofertuesi i renditur i dyti në listën e ofertave dhe kështu me rradhë, deri në ofertuesin e renditur e fundit të mbetur në klasifikim.

Afati i dorëzimit të dokumentave: Brenda 2 (dy) orëve nga momenti i shpalljes së fituesit.

Në ofertën e tij, ofertuesit duhet të paraqesë të dhënat e plota të personit të kontaktit në sistem.